



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME DURRËS SH.A

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Rikonstrukcion pjesor i rrjetit të ujësjellësit në Bashkinë Durrës”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45247130-0 - Punime ndërtimi për ujësjellës

VLERA E FONDIT LIMIT:

99,965,370.00 Lekë (Nëntëdhjetë e nëntë milionë e nëntëqind e gjashtedhjetë e pesë mijë e theqind e shtatedhjetë) lekë pa TVSH.

Argumentimi: Bazuar në preventivin e përlogaritur mbështetur në VKM Nr.629, date 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ujësajllës Kanalizime Durrës sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/ kualifikimit (shtojca 7)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”si dhe nenit

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe merr përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet apo nënkuptohet në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim, për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet (jo më e vogël se vlera e fondit limit).**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021 të konfirmuara nga administrata tatimore, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shëmin: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për

*auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat..... % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga MPPT/MTI, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- a. NP-1A Punime gjurmimi në tokë
- b. NP-4A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
- c. NP. 5A Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti
- d. NP-7C Ujësjiellësa, gazsjellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje
- e. NP-12A Punime të inxhinierisë së mjedisit
- f. NS-1A Punime për prishjen e ndërtimeve;
- g. NS-8A Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri;
- h. NS-18A Punime topogjeodezike;

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Vendimin Nr. 943, datë 28.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, subjektet fizike / juridikë të huaj duhet të aplikojnë për ekuivalentimin e licencës së huaj në Republikën e Shqipërisë.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në

				kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gjermimi në tokë	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet. Germim kanali me krahe. Germim kanali per tubacionet e lidhjes me konsumatorin, etj	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar.
NP-4	Rrugë, autostrada, mbikalime etj.	Prerje asfalti, Shtrese Asfaltobetoni 4 cm, Shtrese binderi t = 6 cm, Shtrese stabilizant t=10cm, Shtrese cakulli t = 20 cm.	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar.
NP-5	Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti	Instalim tubi me çarje për të zëvendësuar tubin ekzistues per kalimin e tubacioneve (Pipe bursting), Germim kanali me mikrotunel me makineri me drejtim lazer per kalimin e kodres tubacion Dn 75mm	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar.
NP-7	Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi dhe vaditje.	F.V Saraçineskë tip shpringel DN 100 mm Pn 16 bar F.V Saraçineskë tip shpringel DN 80 mm Pn 16 bar F.V Saraçineskë tip shpringel DN 50/65 mm Pn 16 bar F.V. Tub PE100 RC Φ140 mm PN 10atm F.V. Tub PE100 RC Φ125 mm PN 10atm F.V. Tub PE100 RC Φ110 mm PN 10atm F.V. Tub PE100 RC Φ90 mm PN 10 atm F.V. Tub PE100 RC Φ 75 mm PN 10 atm	C	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar.

		<p>F.V. Tub PE100 RC Φ 63 mm PN 10 atm F.v Ajrues me dy veprime 1" PN 20 F.v Kolektor PE/PPR Φ 50 mm me 8 dalje 3/4" (fileto bronxi femer) F.V Saraçineskë me flutur sferë Φ 1 1/2" F-F PN10 F.v Saraçineskë me sferë me magnet Φ 3/4" F-F F.v Niples bronxi 3/4 "</p> <p>F.v Brryle PE Dn25 mm x 3/4" (fileto femer) F.v Adaptor EF Dn50 x 1 1/2" M Hdpe, Pn10 F.v Brryl EF Dn50 mm PE,Pn10 F.v tub PE 100 Pn 16bar DN 25 mm per lidhje me konsumatoret Fashete EF DN (110- 63) x 50 mm Pn 16 at F.V Saraçineskë tip shpringel DN 100 mm Pn 16 bar F.V Saraçineskë tip shpringel DN 80 mm Pn 16 bar F.V Hidrante mbitoksor</p> <p>F.V. Tub PE100 RC Φ140 mm PN 10atm F.V. Tub PE100 RC Φ125 mm PN 10atm F.V. Tub PE100 RC Φ110 mm PN 10atm F.V. Tub PE100 RC Φ90 mm PN 10 atm</p>		
--	--	---	--	--

		F.V. Tub PE100 RC Φ 75 mm PN 10 atm F.V. Tub PE100 RC Φ 63 mm PN 10 atm F.V. Tub PE100 RC Φ 32 mm PN 10 atm Prova ne tubin En 805 Pastrim tubi Punime per puseta shperndarese			
NP-12	Punime inxhinierisë mjedisit	të së	Punime per riaftesimin e rikthimin ne gjendje fillestare te zonave ku do te punohet	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar.
NS-1	Punime për prishjen e ndërtimeve		Prishje shtrese betony, Prishje shtrese pllaka betoni ne rruge dhe trotuare, Prishje bordura betoni ne rruge dhe trotuare	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar.
NS-8	Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri		Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka, F V bordura betoni 15x30 cm,	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar.
NS-18	Punime topogjeodezike;		Piketim per realizimi te te gjitha punimeve te parashikuara ne projekt. Matje e punimeve te kryera per dokumentim te tyre. Matje per hartimin e viztimeve te punimeve si jane realizuar ne fakt.	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr 42 date 16.01.2008 I ndryshuar.

2.3.3 Operatori ekonomik në konkurim duhet të jetë i pajisur me licencë nga Qendra Kombëtare e licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomik, licencat profesionale të kërkuara sa më sipër duhet të plotësohen nga i gjithë grupi i marë së bashku.

Argumentimi: Mbeshtetur në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”. Nga punimet e ndertimit do të gjenerohen mbetje që duhen transportuar në venddepozitim të caktuar nga AK.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, në listëpagesat e (3) tre muajve të fundit të shoqërisë si më poshtë:

- a. 1 (një) Inxhinier Hidroteknik drejtues teknik në licencën e e shoqërisë.
- b. 1 (një) Inxhinier Ndërtimi drejtues teknik në licencën e e shoqërisë.
- c. 1 (një) Inxhinier Gjeoded/Markshajder/Topograf drejtues teknik në licencën e e shoqërisë.
- d. 1 (një) Inxhinier Mjedisi drejtues teknik në licencën e e shoqërisë.
- e. 1 (një) Inxhinier Mekanik drejtues teknik në licencën e e shoqërisë.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

diploma universitare, kontrata noteriale e punes, CV, libeza e punes, listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas formularit E/Sig-25, për (3) tre muajt e fundit.

Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera si dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësit të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar në DST.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Ky kriter është vendosur *bazuar edhe në afatin e parashikuar për kryerjen e punimeve në volumnin e punimeve si dhe në zërat e preventivit.*

2.3.5 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **stafin mbështetës**, në listëpagesat e (3) tre muajve të fundit të shoqërisë si më poshtë:

- a. 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- b. 1 (nje) Inxhinier pajisur me çertifikatë per "Ekspert per ndihmen e pare dhe nderhyrjen ndaj emergjencave".
- c. 1 (nje) Inxhinier pajisur me çertifikatë per "Përgjegjes për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetin në punë" në përputhje me Ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".
- d. 1 (një) Inxhinier Gjeolog
- e. 1 (një) Teknik Ndërtimi

Për stafin e sipërcituar të paraqitet dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat/liçenca e inxhinierëve, diplomat/dëshmi profesionale e teknikut te ndertimit ose ekuivalenti i tij/saj, kontrata pune, listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas formularit E/Sig-25, per (3) tre muajt e fundit.

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësit të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 8 te DST.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar në DST.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Bazuar ne ligjin Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Ky kriter eshte vendosur *bazuar edhe ne afatin e parashikuar per kryerjen e punimeve ne volumin e punimeve si dhe ne zerat e preventivit.*

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, në listëpagesat e (3) tre muajve te fundit të shoqërisë si më poshtë:

- a. 1 (një) Hidraulik
- b. 1 (një) Murator
- c. 1 (një) Hekurkthyes
- d. 1 (një) Karpentier
- e. 1 (një) Manovrator
- f. 1 (një) Drejtues Mjeti / Shofer

Për stafin e sipërcituar të paraqitet dokumentacion që vërteton profesionin si: dëshmi profesionale të punonjësve ose ekuivalenti i tij/saj, listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sipas formularit E/Sig-25, per (3) tre muajt e fundit.

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësit të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 8 të DST.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Ky kriter është vendosur *bazuar edhe në afatin e parashikuar për kryerjen e punimeve në volumnin e punimeve si dhe në zërat e preventivit.*

Qëllimi kryesor i autoritetit kontraktor është kryerja e punimeve të kontratës objekt prokurimi në përputhje me cilësinë e kërkuar dhe nga staf teknik i kualifikuar. Për arritjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar disponueshmërinë e stafit teknik të kualifikuar të pajisur me dëshmi profesionale sipas legjislacionit në fuqi si rezultat i punës që do të realizohet në disa fronte të cilat kërkojnë aftësi teknike dhe profesionale.

Kerkesat e mesiperme janë të mbështetura në zërat e punimeve që janë parashikuara në preventiv si edhe në krijimin e besueshmerisë së AK në zotërimin e kualifikimeve të nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, makineritë apo pajisje të tjera asetë fizike të nevojshme për të zbatuar kontratën ku autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për personelin kryesor që ka në dispozicion OE, **duke qenë në perpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësitë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës për të krijuar besueshmerinë publike nga OE për realizimin me efikasitet dhe efikasitet të kontratës.**

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë, mjedisit dhe sigurisë së informacionit. Për këtë duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme:

- a. Çertifikate për Sistemin e menaxhimit të cilësisë (ISO 9001:2015) ose ekuivalente (e vlefshme).
- b. Çertifikate për Sistemin e menaxhimit të mjedisit (ISO 14001:2015) ose ekuivalente (e vlefshme).
- c. Çertifikate për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë (ISO 45001:2018) ose ekuivalente (e vlefshme).
- d. Çertifikate për Sistemin e e tibatacioneve plastike për furnizimin me ujë (ISO 1452-1:2009) ose ekuivalente (e vlefshme).

Certifikatat duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga

Republika e Shqipërisë. Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomik, certifikimet të kërkuara sa më sipër duhet të plotësohen nga i gjithë grupi i marë së bashku.

Argumentimi: Bazuar në neni 44 “Kerkesat e cilesise” te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” janë kërkuar certifikata ISO.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 30 persona** në listëpagesat e (3) tre muajve te fundit të shoqërisë. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Punonjësit e sipërcituar duhet të jenë të siguruar me kohë të plotë.

Operatori ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet te dorezoje dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, gjatë (3) tre muajve të fundit të shoqërisë.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për (3) tre muajt e fundit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Llogaritja e numrit të punëtorëve është bërë bazuar në vëllimin e punimeve që do të kryhen sipas preventivit të punimeve në zbatim të VKM Nr 629 datë 15.07.2015, Për Miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre.

Praktikisht: Vëllimi i punimeve në leke: Pagën orare: orë/ditë: ditëpunë/muaj: afatin kohor të punimeve = Nr i punëtorëve.

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1.	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtës (20 – 25) Ton te pajisur me vinc me krah mbi 12 m dhe kapacitet ngrites mbi 4.5 ton.	Pronesi ose me qera	Cope 1
2.	Kamionçine veteshkarkues me kapacitet mbajtës (3.5 – 4) Ton	Pronesi ose me qera	Cope 1
3.	Kamionçine veteshkarkues me kapacitet mbajtëse (1.5 – 2) Ton	në pronësi ose me qira	Copë 2

4.	Ekskavator me zinxhire me peshe jo me te vogel se 20 ton i pajisur me çekiq/matrapik per thyerje betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
5.	Minieskavator me zinxhire me peshe me te madhe se 8 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
6.	Minieskavator me zinxhire gome me peshe me te madhe se 2 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
7.	Rul vibrues me goma me peshe me te madhe se 8 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
8.	Rul vibrues per asfalt mepeshe jo me pak se 2 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
9.	Autobetoniere vetngarkuese me peshe jo me te vogel se 5.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
10.	Rimorkio per levizjen e mjeteve me kapacitet mbajtese jo me te vogel se 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
11.	Automjet vetshkarkues me zinxhir gome per terrene te ngushta / veshtira	në pronësi ose me qira	Copë 2
12.	Fadrome me goma me peshe me te madhe se 7 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
13.	Minifadrome me rrota gome me peshe jo me pak se 2 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
14.	Instrument Topografik (Stacion Total, GPS)	në pronësi ose me qira	Copë 1
15.	Automjet teknologjik per pastrim tubi, i pajisur me pompe pastrimi me presion pune jo me pak se 150 bar, prurje jo me pak se 300 litra/minute dhe sonda me gjatesi jo me pak se 70m, e pajisur me pompe vakumi per thithjen e materialeve me kapacitet jo me te vogel se 1400 m ³ /ore, e pajisur me bot per largimin e mbeturinave me kapacitet bartes jo me pak se 5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
16.	Automjet teknologjik per inspektimin e tubave e pajisur me sistem kamerash per gjatesi inspektimi jo me pak se 200 m	në pronësi ose me qira	Copë 1
17.	Dedektor rrjetjesh i paisur me dedektor te levizshem dhe kamer inspektimi (Pajisja te shoqerohet me foto dhe katalog)	në pronësi ose me qira	Copë 1
18.	Pajisje per ngjitje tuba PE ose HDPE	në pronësi ose me qira	Copë 1
19.	Pajisje testimi tubash sipas standartit EN 805 me printer te inkomporuar	në pronësi ose me qira	Copë 1
20.	Makineri për shpim horizontal për të zëvendësuar tubin ekzistues për kalimin e tubacioneve	në pronësi ose me qira	Copë 1
21.	Makineri me lazer per germim kanali nentokesor mikrotunel d=140mm, per kalimin e kodres	në pronësi ose me qira	Copë 1
22.	Motopompe per largimin e ujrave te ndotura me prurje deri ne 3500 litra/minute, presion mbi 8 bar.	në pronësi ose me qira	Copë 1
23.	Motopllake per ngjeshjen e kanaleve me peshe mbi 300 kg.	në pronësi ose me qira	Copë 1
24.	Motokompresor me peshe jo me pak se 400 kg dhe presion pune jo me pak se 8 bar.	në pronësi ose me qira	Copë 1
25.	Prerëse asfalti me peshe mbi 800 kg	në pronësi ose me qira	Copë 1
26.	Hekmeta Pune	në pronësi ose me qira	Copë 30

27.	Komplet i ndihmes se shpejte	në pronësi ose me qira	Copë 1
28.	Tabela paralajmeruese	në pronësi ose me qira	Copë 100
29.	Kalleperi derrase	në pronësi ose me qira	m ² 100

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Certifikatë për transport mallrash, duhet të shoqerohet me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i saj.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jenë të dukshme karakteristikat e kërkuara dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar nga ofertuesi.
- f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKD sh.a (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për makinëritë e mesipërme.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinërive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Për miratimin e manualit teknik të cmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre “(përllëgaritja e oreve të punës si edhe të mjeteve të nevojshme), Kodi i Punës në RSH, si edhe bazuar në dosmosdoshmerine e realizimit të objektit.

Ky kriter është vendosur bazuar edhe në afatin e parashikuar për kryerjen e punimeve në volumnin e punimeve si dhe në zërat e preventivit.

2.3.10 Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkatës të publikuar në SPE, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë si më poshtë:

a) F.V. Tub PE100 RC+ISO 9001:2015 të prodhuesit;

Në rast paraqitjeje të autorizimit nga Distributori duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar.

b) F.V Mates uji me LoRa, Mates uji Multi Jet Ø 3/4"

Në rast paraqitjeje të autorizimit nga Distributori duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar.

c) Per materialet hidraulike (Ajruet me dy veprime, Kolektor PE/PPR Ø 50 mm me 8 dalje 3/4", Saraçineskë me flutur sferë Ø 1 1/2" F-F PN10, Saraçineskë me sferë me magnet Ø 3/4" F-F, Brryl EF Dn50 mm, Adaptor EF Dn50 x 1 1/2" M Hdpe Pn10, Fashete EF DN (110-63) x 50 mm Pn 16 at, Saraçineskë Pn 16 bar)

Në rast paraqitjeje të autorizimit nga Distributori duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar

Operatori ekonomik ofertues për mallra hidraulike duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve të mallrave objekt prokurimi ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesi/it me qëllim vërtetimin e përmbushjes së gjitha kushtet dhe kërkesat e vendosura në Specifikimet teknike. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, dokumentet e mësipërme duhet ta paraqesë anëtari i grupit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërit FV të referuar preventivit të objektit të prokurimit.

Argumentimi: *Njësia e prokurimit gjatë hartimit të kriterëve të vecanta të vlerësimit ka vendosur si kriter autorizimin e prodhuesit ose nga distributori i autorizuar, të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto materiale hidraulike në këtë procedurë prokurimi, bazuar në pikën 1/c të nenit 77 të LPP dhe në nenet 39 dhe 40 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, pasi në preventivin e punimeve ka zëra për lyerjen e objektit, për këtë arsye si dhe duke*

u nisur nga pesha specifike, AK e ka parë të domosdoshme kërkimin e autorizimit të prodhuesit për të garantuar cilësinë e mallit që do të përdoret për nga vetë rendesia që ka ky objekt.

Eshte e vertet qe keto mallra jane lehtësisht të gjetshme në treg e pikerisht ne kete kuader dhe marrja e autorizimit të prodhuesit ose e distributorit të autorizuar është një dokument i cili lëshohet nga firmat që tregëtojnë këto produkte. Kerkesa e ketij dokumenti qe ne kete faze krijon nje lehtesi per Autoritetin Kontraktor, pasi ne kete menyre siguron cilesine, specifikimet teknike te cilave do te jene lehtesisht te kontrollueshe gjate fazes se zbatimit ne reference me dokumentat e paraqitura gjate kualifikimit. Nuk kane qene te pakta rastet ku OE gjate zbatimit te kontrates nuk kane respektuar standartet dhe specifikimet teknike. Nepermjet dorezimit te ketij dokumentacioni qe ne fazen e vleresimit asnje OE ekonomik nuk i shmanget dot detyrimet qe gjate zbatimit te perdor te njejtin mall. Per t'u theksuar ne vijim te sa me siper cituam, ky kriter eshte vendosur i tille me qellim verifikimin e permbushjes se specifikimeve teknike te materialeve/mallrave qe do te perdori OE.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike te ngarkuara ne sistemin e APP-se jane hartuar nga specialistet perkates se teknikes.

*Shënim: Përcaktoni specififikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***